

KONTRATA E THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 18/07/2017:

1. Znj.YESIM ERGUN i dat 18.06.1986 dhe me nr Pass- U 13459690
qe ne vijim do te quhen ortak: Bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me
ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te
hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar
", ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Konsulente ne fushen e shitjes dhe te blerjes per tregun e jashtem dhe si homeoficce
Shitje Blerje produktesh te ndryshme ushqimore textile etj. Te bleje te shesi dhe
te jape me qira objekte truall toke etj. Subjekti te kete te drejte te lidhi
marreveshte apo te beje Join Invetion. Te shesi bleje dhe te jape me qira
makineri pune.. Te kete te drejte te bleje makineri pune dhe makineri prodhimi
dhe perdorimi personal dhe shesi gjithashtu te marri dhe jap me qira brenda
dhe jashte vendit. projektim zbatim te perpunimit te ndertimit montimit ne
godina banimi civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqerore, vepra ujore,
kanaklizime te ndryshme, rruge ura e vepra arti, punime komunale, etj. Import -
eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice dhe
pakice etj si; Rritje tregtim dhe shitje e bagetise se gjalle.Tregtimin e artikujve te
ndryshem, veshje, tekstileve, tregtimin artikujt te ndryshem industrial.Hapje te
bar kafeve dhe lavazheve parking me qira Tregtim pajisjesh elektro-shtepiake,
elektronike, elektrike, kopjuterike, higjeno - sanitare, hidraulike, prodhime
qermike, artizanati, pajisje zytrash produkteve te pastrimit produkteve me baze
mjekesore etj. Hapjen e agjensive turistike dhe administrimin - menaxhimin e
tyre.Veprimtaria financiare e kembime Valutore,
Transportimin e mallrave te vete apo te te treteve, me mejetet e veta apo te te
treteve, brenda dhe jashte vendit. Transport personash benda dhe jashte vendit,
me mejetet e veta apo te te treteve. Tregtimin dhe prodhimin e materialeve te
ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit. Tregtim prodhimesh

kozmetike e estetike. Punime duralumini e tregtimin e tyre. Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi, dyer, dritare etj, divane, kanepë, dhoma gjumi, dhoma femijesh, tavolina karrige, kolltuqe, aksesore te ndryshem te mobilerive etj. Shit blerje te produkteve dhe te gjitha lloveje te ndryshme mallrave per femije ushqimor tekstil apo ne perdorim. Cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtsnme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtsnme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

- 2.1. Ortaket vendosen qeshoqerine ta emertojne **NES FOREIGN TRADE SHPK**
- 2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne **Durres , Rruga Grigor Durrsaku Lagjia Nr 3 Pallati i Reiffeisen bank kati i 9 Hyrja 17**
- 2.3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

- 3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
- 3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtasin Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin
- 3.4. Shoqeria do te kete vullen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.
- 4.5. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj
- 4.6. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar

Neni 5. Kohezgjatja

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte 100.000 (Njeqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 1 kuota

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

- **Z. YESIM ERGUN** 100 000 – 1 kuote, pekatesisht 100%

6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket

6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakëve te shoqerise.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakëve

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

8.2. Emertimi i shoqerise tregtare,kapitali themeltar,NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerisa jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortakët,administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortakët e shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejttat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortakët. Te drejttën e thirrjes se Asamblese e kane Administratori,Eksperti kontabel i autorizuar ose ortakët e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortakët mund te perfaqesohen ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi,duke qene i autorizuar me prokure te posacme,dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejttën e perfaqesimit.

Ortaku mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar,duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast,ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaku i vetem.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen ne nje regjister te vendimeve,te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortakët e shoqerise kane te drejte te marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

- 10.1.** Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise
- 10.2.** Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaket
- 10.3.** Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori Z. YESIM ERGUN i dat 18.06.1986 dhe me nr Pass- U 13459690**
- 10.4.** Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese)vjet me te drejte ripertesitje ne perfundim te mandatit.
- 10.5.** Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektive te saj.
- 10.6.** Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.
- 10.7.** Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres
- 10.8.** Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane:



- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortakët :
- perfaqeson shoqerine tregtare.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim
- krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercesojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- raporton perpara ortakëve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku i vetem.
- kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise
- te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjithe veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- ti propozoje ortakëve per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
- ti propozoje ortakëve per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Neni 11-Marreveshjet e ndaluara

11.1.Administratorit ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejohe te kontraktojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve .Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakëve qe jane persona juridike.



11.2.Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj çdo personi ndermjetes.

Kreu VI

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

12.1.Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

12.2.Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaket.

12.3.Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13-Kontrolli i Shoqerise

13.1.Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortaku i vetem.

13.2.Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar , si dhe gjendjen financiare te shoqerise.Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon ghithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve.Mund te aktivizoje eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

13.3.Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakeve.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 14

14.1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

14.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi, ortaku i vetem emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

14.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortaket e shoqerise.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

15.1. Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent

16.2. Ky staut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET

Znj. YESIM ERGUN

Yesim ERGUN